

V E N D I M
Nr.528, datë 1.11.1993

**PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN E KËSHILLIT TË MINISTRAVE NR.328,
DATË 30.6.1993 "PËR DHËNIEN E NDIHMËS EKONOMIKE"**

Me propozimin e Ministrisë së Punës, të Emigracionit dhe Përkrahjes Sociale, Këshilli i Ministrave,

V E N D O S I:

1. Në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.328, datë 30.6.1993, pika 3 ndryshohet si vijon:

"Ndihma ekonomike mujore e pjesshme për familjen me të ardhura të pamjaftueshme llogaritet si diferencë e ndihmës ekonomike mujore të plotë që përcaktohet në pikën 2 të këtij vendimi dhe të ardhurave aktuale të familjes. Kjo ndihmë nuk përfitohet nëse është më e vogël se 5 për qind e masës së plotë të saj.

Për familjet bujqësore me të ardhura të pamjaftueshme masa e përfitimit mujor përbëhet nga ndihma ekonomike mujore e pjesshme dhe kompensimi për frymë për efekt të rritjes së çmimit të bukës. Masa e përfitimit llogaritet si diferencë ndërmjet 60-80 për qind të shumës së ndihmës ekonomike mujore të plotë të përcaktuar në pikën 2, së bashku me kompensimet e përcaktuara në pikën 4 të këtij vendimi dhe të ardhurave aktuale të familjes, në të cilat përfshihen edhe të ardhurat nga toka. Ky përfitim nuk është më i vogël se 5 për qind e masës së plotë të tij".

2. Në pikën 4 shtohet një paragraf me këtë përmbajtje:

"Përfshihet përfitojnë kompensimet e përcaktuara në paragrafin e parë të kësaj pike familjet që përfitojnë ndihmë ekonomike mujore të pjesshme, kur të ardhurat e tyre përbëhen nga:

- a) pensioni i personave të paaftë për punë dhe jo në moshë pune;
- b) pensioni i personave të aftë për punë dhe jo në moshë pune;
- c) pension familjar, i cili merret në zyrën e përmbartimit".

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë, i shtrinë efektet financiare prej datës 1 korrik 1993 dhe zbatohet deri në datën 31 dhjetor 1993.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Aleksandër Meksi